

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

MBLEDHJE BORDI

VENDIME

GJATË MUAJIT SHKURT BORDI I ERE-S KA ZHVILLUAR 3 MBLEDHJE, QË KANË REZULTUAR NË 14 VENDIMMARRJE, NDËR TË CILAT PËRMENDIM FILLIM E PROCEDURËS SË LICENCIMIT PËR NJË SUBJEKT NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NJË SUBJEKT NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, SI DHE NJË SUBJEKT NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE; DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN 306/2023 TË BORDIT TË ERE-S; NJOHJEN E LICENCËS SË NJË SUBJEKTI I CILI MË PARË ËSHTË LICENCUAR NGA ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS PËR AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE; SI DHE SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË DY SUBJEKTEVE TË LICENCUARA PËR NDRYSHIME NË LIDHJE ME VENDOSJEN E KUOTAVE SI KOLATERAL NDAJ PALËS KREDIDHËNËSE, APO ME NDRYSHIMIN E ORTAKUT PËR TË CILAT NDËR TË TJERA NEVOJITET DHE MIRATIMI I BORDIT TË ERE-S.

PËR TU BËRË ME DIJE ME KËTO VENDIME NË MËNYRË MË TË DETAJUAR JU, JU FTOJMË TË VIZITONI FAQEN TONË ZYRTARE WWW.ERE.GOV.AL NË KATEGORINË VENDIME.

NDËR VENDIMET E TJERA QË MUND TË PËRMENDIM JANË:

✓ PËRCAKTIMI I ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË FURNIZUAR NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN JANAR 2024 PREJ 13.80 LEKË/KWH PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV.

✓ MIRATIMI I ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA PRODHUESIT EKZISTUES ME PËRPARËSI NGA BURIMET FOTOVOLTAIKE ME KAPACITET TË INSTALUAR DERI NË 2 MW PREJ 95.04 EURO/MWH, PËR VITIN 2023. KY VENDIM VJEN SI DETYRIM I LIGJIT NR. 24/2023 "PËR NXITJEN E PËRDORIMIT TË ENERGJISË NGA BURIMET RINOVUESHME".

✓ ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJES NDËRMJET SHOQËRIVE TREN SUN SYSTEM SH.P.K., SUN BEAT SYSTEM SH.P.K., NTSP SH.P.K., KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK SH.P.K. DHE SHOQËRIVE FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË SH.A. DHE OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A.; ERE PAS SHQYRTIMIT TË DOKUMENTACIONIT DHE INFORMACIONIT TË PARAQITUR NGA PALËT, PËRCAKTOI DETYRAT PËRKATËSE PËR SECILËN PALË TË PËRFSHIRË NË MOSMARRËVESHJE DHE VENDOSI DETYRIMIN E RAPORTIMIT NË ERE BRENDA DATËS 15 MARS 2024, PËR ECURINË E ZBATIMIT TË KËRKESAVE TË ERE TË SANKSIONUARA NË KËTË VENDIMMARRJE, SI DHE ZBATIMIN E TIJ BRENDA MUAJIT MARS 2024.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

AKTIVITETE

KONSULTIME

Enti Rregullator i Energjisë, në datën 09 shkurt 2024, ftoi në një takim prezantues në ambientet e tij, të gjithë të licencuarit aktive në aktivitetin e furnizimit, me qëllim njohjen me platformën e krahasimit të çmimeve të shitjes së energjisë elektrike (PCT). PCT është platforma e prokuruar nga ERE dhe shërben për krahasimin e çmimit të energjisë elektrike të ofruar në tregun e lirë nga furnizuesit e licencuar. Nëpërmjet përzgjedhjes së profilit të konsumatorit si dhe ofertave të furnizuesve, mund të garantohet informacioni i nevojshëm i konsumatorit për furnizimin në treg të lirë. ERE prezantoi për shtatë të licencuarit pjesëmarrës, modalitetet e përdorimit të kësaj platforme nga furnizuesit, me qëllim lehtësimin e punës në operimin e saj, duke hedhur kështu një hap të rëndësishëm drejt promovimit të një tregu konkurrues e alternativ të çmimeve të furnizimit me energji elektrike, për të gjithë ata konsumatorë të cilët kanë plotësuar kriteret ligjore të daljes në treg të lirë. PCT, me lançimin e saj, do të jetë një vitrinë për publikimin e ofertave të furnizimit me energji elektrike nga furnizuesit në treg të lirë, dhe një mjet praktik për vlerësimin e çmimeve nga ana e konsumatorit për të mundësuar përzgjedhjen e furnizuesit nga ana e tij.

[ERE ka nisur konsultimet për Metodologjinë e llogaritjes së detyrimit për energjinë e rinovueshme për t'u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike.](#)
[Kjo metodologji hartohet në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 24/2023 Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme, nenit 19, gërma b\) e Ligjit nr. 43/2015 Për sektorin e energjisë elektrike, i ndryshuar.](#)
[Aktualisht ka dërguar komente shoqata AREA, me të cilat mund të njiheni duke klikuar në këtu.](#)



Gjatë muajit shkurt, pjesë e aktivitetit të ERE-s kanë qënë dhe seancat dëgjimore me subjekte të licencuar si dhe palë interesi, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo marrjen e qëndrimeve të palëve me qëllim një vendimmarrje më të plotë.

Ndër to mund të përmendim gjashtë seanca dëgjimore të zhvilluara nga Drejtorja e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me subjekte të licencuara dhe palë të përfshira në proces, të cilat në thelb kanë patur sqarime dhe diskutime mbi kapacitetet faktike të prodhimit të energjisë së subjekteve në fjalë, apo ecurinë në plotësimin e kushteve të vendimmarrjes së licencimit, në zbatim të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe hbeqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike; një seancë dëgjimore të zhvilluar me FTL sh.a., FSHU sh.a. dhe OST sh.a. në një diskutim të përbashkët mbi veprimet operacionale për garantimin e furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit për konsumatorët fundorë sipas kriterëve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi; si dhe dy seanca dëgjimore nën drejtimin e Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes konsumatorëve dhe FSHU sh.a.